

J E T A S H K E N C O R E

KËRKIMET DIALEKTORE NË VITET 1961-64

Përveç anketave të bëra me ekspedita në viset e ndryshme të Shqipërisë për mbledhjen e materialit dialektor dhe sistemit të tij në Arkivin e Sektorit të Dialektologjisë, gjatë katyre viteve të fundit, 1961-63 e në gjysmën e parë të vitit 1964, janë hartuar edhe 15 monografi e skica monografike, ku janë përshkruar një sërë të folmesh të anëve të ndryshme të vendit tonë me tiparet më të rëndësishme dhe me fenomenet dialektore më karakteristike të tyre.

Si objekte në këto punime janë marrë në radhë të parë krahina që formojnë një-sira të dalluara gjuhësore-etnografike, herë një-sira të caktuara gjeografike ose administrative, e vetëm në ndonjë rast e folmja e një vendbanimi të vetëm. Të folmet e studjuara u përkasin zonave të ndryshme dhe degëzimeve të ndryshme dialektore të shqipes, kryesisht zonave të panjohura ose pak të njohura nga ana gjuhësore e dialektore. Të folmet e përshkruara janë këto: të Nikaj-Merturit, Tropojës, Lurës, Reç e Dardhës, Luznisë dhe Zerqanit në verilindje e juglindje; Pukës e Bregut të Bunës në veriperëndim; të Krujës, Peqinit dhe Shpatit në Shqipëri të mesme; të Bregdetit të Poshtëm, Kurveleshit dhe të Muzinës në jugperëndim, dhe e folmja e Korçës në juglindje.

Ndër to janë botuar vetëm 3 skicat mbi të folmet e Tropojës, Lurës dhe Bregdetit të Poshtëm, të tjera do të botohen me radhë në numrat e ardhshëm të "Studime Filologjike" dhe në përmbledhjen "Dialektologjia shqiptare" që do të përgatitet për shtyp së afërmi.

Po japim një vështrim të përgjithshëm të tyre.

Në punimin mbi të folmen e krahinave të rrethit të Tropojës nga J. Gjinari (Buletin për Shkencaat Shoqërore 1963, nr. 4, fq. 163-193) është dhënë përshkrimi i së folmes së tri krahinave të këtij rrethi, e pikërisht të Krasniqes, Gashit dhe Bytycit, në bazë të materialeve të mbledhura në verin e vitit 1930 në një numur fshatrash të katyre tri krahinave. Autori ka konstatuar qenjen e një të folmeje të përbashkët për të tria, me ndryshime të parëndësishme midis tyre, e folme me tipare të gegërishtes

verilindore. Në këto anë mbetet ende pa u gjurmuar vetëm e folmja e krahinës së Hasit.

Një ane tjetër të kësaj zone i është kushtuar skica e E. Lafes "E folmja e Nikaj-Merturit". Krahinë e theksuar malore me maja mbi 2500 m., midis Malësisë së Gjakovës dhe Malësisë së Shkodrës, Nikaj-Merturi ka qenë bërë objekt kërkimesh folkloristike, po jo gjer më tani vëzhgimesh dialektore, me përjashtim të ndonjë vërejtje të shpejtë të prof. M. Lambertit për ndonjë fshat. E folmja paraqet interes të veçantë si për një seri konservacionesh që vërehen aty, ashtu dhe për pozicionin e saj si e folme e gegërishtes verilindore në kufi me gegërishten veriperëndimore.

Lura, të folmen e së cilëse ka përshkruar Q. Haxhihasani "Vëzhgime gjuhësore në krahinën e Lurës", (Bulet. Shk. Shoq. 1963, nr. 4, fq. 116-164) një krahinë malore e përmbledhët, shumë e brendëshme dhe e veçuar e trevës së Dibrës, vatër e fuqishme legjendash për Skënderbenë, ka një ligjerim që i përket gegërishtes juglindore.

Një krahinë tjetër e brendëshme e katyre anëve, e pakërkuar fare për nga ana gjuhësore, është Reç e Dardha, në lindje të Lurës, në cepin verior të trevës së Dibrës. E folmja e saj është gjurmuar nga B. Beci. Po nga ky janë përshkruar dhe të folmet e dy krahinave të tjera të kësaj treve, që shtrihen në zona të ndryshme të saj: të Luznisë në qendër dhe të Grykës së madhe (Zerqanit) në jugë. Me këto punime e me monografinë për të folmen e Lumës që po përgatitet nga Sh. Hoxha, plotësohet kuadri i të folmeve të kësaj zone me aq interes për dialektologjinë shqiptare, sidomos për zhvillimet e shumta fonetike karakteristike për të.

Njohuritë e mëparëshme mbi gegërishten veriperëndimorel) u pasuan këto vite me

1) Për të, përveç materialeve të shumta folkloristike, materialeve të botuara nëpër gramatika dhe ndonjë vëzhgimi të rastit e vërejtjesh të shpejta, kemi përshkrimin e hollësishëm të së folmes së Dushmanit (1951) nga albanologu polak W. Chimo-chovski, dhe përshkrimin e së folmes së Shkrelit nga B. Beci, dorëshkrim.

punimin e Xh. Topallit mbi të folmen e zonës së haphtë të Pukës dhe atë të J. Gjinarit mbi të folmen e Bregut të Bunës.

Skica e J. Gjinarit mbi të folmen e Kruges e të Malësisë së saj është përpunimi i materialeve të mbledhura në vetë qytetin e Krugës dhe në dy fshatra të afërme të Malësisë së saj, që i përkasin krahinave të Benës e të Kurbinit.

Skica monografike për të folmen e Peqinit nga M. Çeliku është hartuar në bazë të gjurmimeve të bëra në vetë qytetin e Peqinit, në krahinën fushore të Darsisë, në bregun e majtë të Shkumbinit, dhe në Malësinë e Peqinit (Vrap). Në një punim tjetër të M. Çelikut është përshkruar e folmja e Shpatit, krahinë malore-kodrinore e pjesërisht fushore në jug të Elbasanit, që përfshin 52 katunde, me materiale të mbledhura në katër fshatra të zgjedhur të saj. Me përshkrimin e kësaj së folmeje, ku gërshetohen tipare të gegërishtes me ato të toskërishtes, pasurohen njohuritë tona mbi këtë zonë interesante kalimtare që shtrihet në të majtë të Shkumbinit, kryesisht midis Shkumbinit e Devollit.

Skicave të shumta që janë punuar në pesëvjeçarën e mëparmë mbi të folme të ndryshme të toskërishtes veriore, i u shtua edhe një tjetër, me punimin mbi të folmen e Korçës nga J. Gjinari, ku është parë të folurit e qytetit, po ashtu edhe i disa fshatrave të fushës së Korçës.

Ka shkuar mjaft përpara njohja e të folmeve të labërishtes; janë përshkruar e folmja e trevës së gjerë malore të Kurveleshit ajo e Bregdetit të Poshtëm (Piqeras), Borsh, (Nivice-Bubar) dhe ligjerimi i fshatit Muzinë pranë Delvinës, me interes për disa konservacione e për kontakte gjuhësore. Skica e së folmes së Bregdetit të Poshtëm është botuar në këtë organ, 1964, nr. 1 e 2.

Janë në hartim e sipër monografia për të folmen e Kavajës nga M. Çeliku dhe ajo për çamërishten. Poashtu punohet nga J. Kastrati për të folmen e Thethit të Shalës së Dukagjinit, kufi me Malësinë e Madhe.

Vitin e ardhshëm do të bëhen punime mbi të folmet e zonës së gjerë të Mirditës, të qytetit të Durrësit e të rrethinave të tija, të qytetit të Gjirokastrës etj.

Kështu nga fundi i 1965-ës kryhet në vija të përgjithëshme faza e parë e eksplorimit dialektor të të gjithë Shqipërisë, duke u mbledhur materiale nga gjithë zonat e saj e duke u hartuar skica monografike e monografi për shumicën dërmuese të të folmeve kryesore e më interesante të degëzimeve të ndryshme dialektore të gjuhës shqipe.

Punimet e kryera kanë lejuar që të fitohet një ide e qartë e ndarjeve dialektore të shqipes dhe e veçorive kryesore të tyre. Po ashtu kanë nxjerrë në dritë mjaft materiale të reja për gramatikën e fjalorin e gjuhës sonë, kanë dhënë shkas për vëzhgime me interes, herë herë me rëndësi të veçantë, për gramatikën historike e historinë e gjuhës.

Ato kanë bërë të mundshëm që të hartohet edhe një tekst i Dialektologjisë shqipe punuar nga J. Gjinari për lëndën përkatëse të Fakultetit të Histori - Filologjisë, hap i parë në përgjithësimin e rezultateve të gjertanishme që do të vijë duke u pasuruar e plotësuar.

Përveç skicave përshkruese të të folmeve të ndryshme, gjatë këtyre viteve janë hartuar edhe studime, artikuj e kumtesa mbi çështje dialektore ose dhe mbi çështje gjuhësore të përgjithëshme të shqipes, po të para në bazë materialeve dialektore, si: "Rotacizmi në shqipet", "Togfjalësia të qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme", "Disa togje foljore të shqipes së sotme", nga M. Çeliku; "Mbi katër inovacione fonetike të gegërishtes qendrore nga B. Beci etj.

Fusha e kërkimeve dialektore ka ardhur duke u zgjeruar. Në të, si në mbledhjen e materialeve, po edhe në përshkrimin e të folmeve, marrin pjesë sot, përveç punonjësve të Sektorit të Dialektologjisë, edhe një numër bashkëpunorësh të jashtëm.

M. D.

JUSTIN RROTA — NË 75 VJETORIN E LINDJES

Më 17 shkurt, gjuhëtari dhe letrari Justin Rrota kremtoi 75 vjetorin e lindjes. Krijimtaria e tij shkencore dhe letrare përfshin një kohë prej pesëdhjetë vjetësh (1914-1964), gjatë së cilës ai i ka dhënë kontribute me vlerë në mënyrë të veçantë studimeve të gramatikës shqipe.

Në fushën e gjuhësisë janë për t'u përmendë artikujt e tij: "Rreth gramatologjisë shqipe", botue në revistën "Hylli i Dritës" (IV, 11, 516, V, 11, 467; VII, 11, 616; VIII, 12, 611; IX, 7, 315), "Rreth problemit të gjuhës letrare" (po aty, VII, 3, 121), "Vrejtje

mbas vrejtesh" (po aty, X, 5, 236) "Rreth lavrimit të gjuhës" (po aty, XX, 6, 45), "Pashtrima buzëqijane "hirje" dhe pjesëza toskënishte "tuke" (në "Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria Shkencat Shoqërore", XVII, 2, 124).

Fushës së morfologjisë historike dhe, njëkohësisht, edhe të sintaksës, i takon studimi: "Analizimi i rasavet t'ëmnit e zhvillimi historik i tyre", botue, së pari, në "Hylli i Dritës" (VII, 5, 252; VII, 6, 315) dhe mandej si broshurë më vedit (Shkodër, 1931, fq. 30). Interes të veçantë paraqit

aty shqyrtimi, me një ekzemplifikim të zgjedhur, i përdorimit të ablativit dhe teza mbi prejardhjen e shpjegimin e të ashtuquajturës trajtë të lokativit, që atij i rezultoi si një rrethore, herë herë e modifikuese në pasojë fenomenesh fonetike, e përdorur si vendore.

Një dëshmi të gjallë të evolucionit të shkrimit të gjuhës sonë gjatë shekujve, jep monografia: "Për historinë e alfabetit shqyp", me pasqyra dhe shembuj nga dokumentat e para të shqipes, nga shkrimatat e qindvjetëve XVI-XIX dhe nga alfabetet e shoqërive të ndryshme. U botue në "Hylli i Dritës", ndër dymbëdhjetë numra të viteve 1931-1935). Ma vonë doli edhe si libër më vehte (Shkodër, 1936, fq. 94). Kjo vepër mund të përfillet si e para e kësaj fare.

Një nga disiplinat, që e ka tërheqë ma tepër, ka qenë sintaksa, së cilës, në vitin 1942, i kushtoi një libër të tanë: "Sintaksi e shqipes" (fq. XI+125) për klasën e dytë, të tretë dhe të katërt të kursit të ulët të shkollave të mesme. Në trajtimin e shumë kategorive sintaktike, e sidomos në kategorizimin e gjymtyrëve të fjalisë, ai duke u mbështetur në drejtmin e traditës të tjera nga ato të paraardhësve të tij, ndoqi rrugë të reja. Për t'u vu në dukje asht aty përdorimi i gjanë i shembullave të marruna nga gjuha e gjallë e popullit, të cilën ai e njohu ma së miri. Në fund të vepërës, auktori ka vendosë dy shtesa. E para flet mbi ndryshimet tipike në mes të gegënishtes dhe të toskënishtes në fonetikë, morfologji, sintaksë dhe leksik me afro 40 vërejtje gjuhësore, duke përbërë një vështrim panoramik dialektologjik me interes. Shtesa e dytë ban fjalë rreth ortografisë së përdorur. Një kapitull interesant është ai që shpjegon fytyrat e sintaksës. Teksti pat edhe një botim të dytë, më 1944 (134 fq.).

Kontribut të çmueshëm ka dhanë Rrota në historiografinë e letërsisë shqipe. Më 1925, ai botoi në Shkodër tekstin "Letratyra shqype" për shkollat të mesme (in 80 me 240 faqe). Në pjesën e dytë të kësaj vepre, nën titullin: "Historija e letërsisë shqype" (fq. 99-227), auktori jep shenime të shkurtra mbi jetën dhe krijimtarinë e shkrimtarëve ma të përmendur bashkë me copa të zgjedhuna prej tyre. Asht kështu njëkohësisht manual i historisë së letërsisë shqipe dhe antologji. Vepër ka randësi, për faktin se është e para në shqipet e kësaj fare. Ajo që botoi Alberto Stratice-i në Milano, më 1896, është italisht ("Manuale di letteratura albanese").

Në tekstin "Shkrimtarët shqiptarë", pjesa I (1462-1878), botue në Tiranë më 1944;

Justin Rrota shkroi tre kapituj: Dokumentat e para të gjuhës shqipe: "Formula e pagzimit", "Fjalorthi i A. von Harff", "Ungjilli i Pashkeut", "Nëshkrimet e Pjanës", "Fjalorthi i Mazrreku" (fq. 3-9), shkrimtarë të vjetër të veriut: "Buzuku", "Budi", "Bardhi", "Bogdani", "Kucendi i Arbënit" (fq. 13-65) dhe pjesërisht kapitullin "Shkrimtarë arbëreshë": "Matranga" (fq. 203-209), "Variboba" (fq. 232-235), "Santori" (fq. 284-286). Të gjitha këto pjesë, auktori ynë i ka pajisë me shenime biografike, historike, gjuhësore dhe me copa të zgjedhuna të komentuese.

Në vëllimin e dytë të tekstit "Shkrimtarët shqiptarë" (Tiranë, 1944), Justin Rrota shkroi kapitullin: "Pashko Vasa" (fq. 15-25), ku dha jetëshkrimin dhe vepërimitarinë letrare të këtij patrioti.

Në historinë e letërsisë shqipe, Rrota ka meritën se që i pari që solli në Atdhe tri kopje fotografike të "Mesharit", më 1929. (Shih artikullin e tij: "Më të parat kopje të fotografueme të Buzukut ndër Shqipëri", në rev. "Nëndori", II, 3, 76). Këty shkrimtari, dijetari ynë i kushtoi edhe studimin: "Monumenti më i vjetri i gjuhës shqype: D. Gjon Buzuku", botue në "Hylli i Dritës" (VI, 1, 33; VI, 2, 108; VI, 4, 231; VI, 5, 292; VI, 10, 569; VI, 12, 671). Ma vonë doli edhe në botim të veçantë (Shkodër, 1930, 66 fq. bot. II, 1938, 57 fq.). Monografia studjon historinë e "Mesharit", trajtën e jashtme të librit dhe landën e tij, auktoria dhe vendin e botimit. Në mënyrë të veçantë janë për t'u shenue këtu vërejtjet rreth gjuhës së Buzukut (ortografia, tingujt, trajtat, dialekti, fjalori). Ma poshtë Rrota ka riprodhuc pesë pjesë nga libri i Buzukut, transkribue, përshtatë në gjuhën e sotme dhe shoqnu me shenime gjuhësore. Në fund ka copa të krahasueme edhe me shkrimtarë të tjerë të vjetër. Në këtë mënyrë, libri luejti edhe rolin e një krestomacie.

Me randësi është edhe punimi: "Hulumtime dhe shenime mbi Gjon Buzukun" (në "Buletin për Shkencat Shqiptare", nr. 3, fq. 173-188). Në këtë studim të ngjeshur auktori hedh dritë mbi Buzukun dhe vendlindjen e tij, mbi gjendjen kishtarë dhe politike të rajonit ku punoi, mbi disa gështje lidhë me botimin e "Mesharit", mbi qëllimin eventual që mund të ketë pasë auktori në të shtypur në kësaj vepre. Të gjitha këto janë shkruar mbi bazën e gjuhës së "Mesharit". Rrota paraqitet një njoftës i mirë i Buzukut dhe i kohës së tij.

Tue u mbështetë në vepërën e lingvistit arbëresh Marco la Piana: "Il catechismo albanese di Luca Matranga", Justin Rrota hartoi studimin e vet: "Shkrimtari më i vjetri i italo-shqypetarvet D. Lukë Matranga (1592), botue në "Hylli i Dritës" (VII, 9, 505) dhe mandej në broshurë të posaçme

1) VII, 12, 676; VIII, 3, 123; VIII, 5, 223; VIII, 7, 341; IX, 9, 455; IX, 1, 1, 514; X, 1, 15; X, 3, 140; X, 11, 529; XI, 1, 8; XII, 2, 61; XII, 4, 171.

(Shkodër, 1931; 20 fq., bot. II,¹ 1939, 30 fq.). Punimi flet mbi jetën dhe veprën e Mar-trangës, mbi gjuhën dhe ortografinë e tij, mbi koloninë e arbëreshëve në Piana dei Greci. Shoqnohet me copa të zgjedhuna dhe të komentueme.

Më 1934, shkollës shqipe ai i dha një traktat të mirë mbi teorinë e letërsisë: "*Letratyra Shqype*" për klasët e ulta të shkollave të mesme, libri I: Parime letratyret, botim i dytë i plotsuem e i pajisun me shembuj të shumtë (301 fq.).

Më 1945, botoi në Shkodër vëllimin "*Rreth votrës*" (224 fq.), që përmbledh novela kallxime, legjenda dhe kujtime, shkrue në një prozë lapidare.

Vitet e fundit ai ka përgatitun një tekst të haptë mbi gjuhën shqipe, tue përlshë leksikun, fonetikën, morfologjinë dhe sintaksën. Aty meritojnë të përmenden në mënyrë të veçantë vëzhgimet me interes që ai ka shkue tue ba mbi fakte të ndryshme morfologjike e materiali që ai ka mbledhë.

J. K.